



01-1990

	<p style="text-align: center;"><b>Republika e Kosovës</b> Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p style="text-align: center;"><b>Komuna e Prishtinës</b> Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	<p style="text-align: center;">PRISHTINA</p> 
---	--	--

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05Nr.391/02-225076/23 dt.24.11.2023, të kërkuësve/bashkëpronarëve, Valon Zhushi dhe Alban Zhushi nga Prishtina rr. “Bajram Bahtiri”, nr. 27, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën afariste të përkoshme, të ndërtuar në kuadër të Planit Rregullues “Zona Ekonomike”, në rr. “Amantia”, “Ramiz Cërnica” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës në procedurë administrative, me datë 01.03.2024, lëshon këtë:

### CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

**I. I LEJOHET** kërkuësve / bashkëpronarëve, Valon Zhushi dhe Alban Zhushi nga Prishtina rr. “Bajram Bahtiri”, nr. 27, sipas kërkesës 05Nr.391/02-225076/23 dt.24.11.2023, përdorimi i ndërtesës afariste të përkoshme auto-servis, me etazhitet P+0, e ndërtuar sipas “Vendimit të Lejes Ndërtimore”, 05Nr.351-56056/23 dt.08.06.2016, dhe “Vendim shtohet bashkëronari i parcelës kadastrale nr. 01423-43 ZK Prishtinë në vendim të Lejes Ndërtimore, 05Nr.351-56056/23 dt.08.06.2016”, 05Nr.351-56056/23 dt.23.02.2023, në parcelën kadastrale nr. 1423-43, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914059-01423-43, ZK Prishtinë, konkretisht në kuadër të Planit Rregullues “Zona Ekonomike”, në Prishtinë.

**II.** Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Amantia”, “Ramiz Cërnica” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 79, në Prishtinë, dhe e njehta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

**III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

**VI.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

### A r s y e t i m

Kërkuësit / bashkëpronarët, Valon Zhushi dhe Alban Zhushi nga Prishtina rr. “Bajram Bahtiri”, nr. 27, me kërkesën me 05Nr.391/02-225076/23 dt.24.11.2023, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën afariste të përkoshme, auto-servis, me etazhitet P+1, e ndërtuar në kuadër të Planit Rregullues “Zona Ekonomike”, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1423-43, ZK Prishtinë, ndërtuar sipas “Vendimit të Lejes Ndërtimore” 05Nr.351-56056/23 dt.08.06.2016, dhe “Vendim shtohet bashkëronari i parcelës kadastrale nr. 01423-43 ZK Prishtinë në vendim të Lejes Ndërtimore, 05Nr.351-56056/23 dt.08.06.2016”, 05Nr.351-56056/23 dt.23.02.2023, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Spektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09 Nr. 391/02-0220684/23 dt. 15.11.2023, ka përcjellë

në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografitë gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Elira Beqaj Haliti; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Shefqet Uruqi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Ismet Haliti; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Vehbi Bresilla; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Qendrim Dragusha me nr. të licensës 255;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa e përkoshme afariste auto-servis mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa e përkoshme afariste auto-servis mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën e përkoshme afariste.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim, përmes kësaj Drejtorie, me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

**I dorëzohet:** Kërkesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZIMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,**

**05 NR. 391/02-225076/23 DT. 01.03.2024**

Zyrtarja,  
Bahtije Vllasaliu  
B.VLLASALIU

